



MBËSHTETJA DHE INKUADRIMI I PRINDËRVE

MBËSHTETJA DHE INKUADRIMI I PRINDËRVE NË DREJTIM TË PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM

Fëmijët në çerdhet e fëmijëve (ÇF) dhe qendrat e zhvillimit të hershëm të fëmijëve (QZHVHF) vijnë nga familje të ndryshme (kultura të ndryshme, përkatësi të ndryshme etnike, gjendje të ndryshme socio-ekonomike, por edhe me qëndrime dhe vlera të ndryshme). Në disa familje prindërit janë të vetmit që kujdesen për fëmijët, por në disa, për fëmijët kujdesen edhe anëtarët e familjes më të gjerë (si p.sh.: gjyshi, gjyshja etj.). Megjithatë, ajo që është e përbashkët për të gjitha familjet është dëshira që fëmijët e tyre të jenë të suksesshëm në jetë dhe të jenë të kënaqur dhe të lumtur. Disa prej tyre e dinë se si ta bëjnë këtë në mënyrë të natyrshme dhe spontane, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për mbështetje plotësuese.

Secila familje në mënyrë të ndryshme, të veçantë dhe unike e mbikëqyr dhe e edukon fëmijën e saj.

Inkuadrimi i prindërve është faktori themelor në sigurimin e ambientit stimulues, si në procesin e mësimin të hershëm të fëmijët e vegjël, ashtu edhe në nivelet më të larta të arsimit. Në kushte kur edukatorët, drejtorët dhe gjithë administrata e ÇF/QZHVHF shfaqin respekt ndaj prindërve dhe e kultivojnë partneritetin me ata, prindërit jo vetëm që ndjehen të qetë dhe të sigurt për fëmijët e tyre, por edhe mund ta rrisin kontributin e tyre personal drejt përmirësimit të mësimin të hershëm dhe përvetësimit të kompetencave të nevojshme për fillimin e tyre të suksesshëm në shkollë.

Ja disa këshilla si ta arrini atë:

- **Shprehuni gjithnjë mirëseardhje prindërve ose anëtarëve të familjes!**

Gjatë pranimit të fëmijës, përshëndeteni prindin me buzëqeshje dhe përkuluni që ta përshëndetni edhe fëmijën, duke e shikuar në sy. Përmendni disa momente të këndshme të ditës së kaluar dhe nxiteni prindin ta këmbejë me ju ngjarje të këndshme nga shtëpia.

Përmendeni programin e planifikuar ditor. Fëmijët, por edhe të rriturit, ndjehen më të sigurt kur e dinë se çka do të presin.

Prindërit dëshirojnë që fëmijët e tyre të jenë të dalluar si individë. Në hapësirën ku gjendet fëmija, ata dëshirojnë ta shohin emrin e theksuar të fëmijës së tyre në mur, në gardërobë ose ta shohin ndonjë punim të tij të ekspozuar në ndonjë vend të dukshëm. Kjo u jep prindërve mesazh të qartë se fëmija i tyre është i respektuar si anëtar i barabartë i gjithë grupit.

Në fillim të vitit jepuni prindërve një broshurë të shkruar në të cilën në gjuhë të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshme do ta përshkruani programin me planin e aktiviteteve, si dhe me sugjerimet e nevojshme, që edhe ata të mund të inkuadrohen. Inkurajoni prindërit që të ndjehen pjesë e rëndësishme e ekipit të ÇF/QZHVHF.

- **Ofrojuni mbështetje prindërve dhe fëmijëve gjatë vendosjes së fëmijës në ÇF/QZHVHF**

Disa prindër, veçmas prindërit e foshnjave dhe fëmijëve më të vegjël, shpesh e kanë ndjenjën e fajit kur i lënë fëmijët që dikush tjetër të kujdeset për ata. Në periudhën kalimtare të fëmijës nga ambienti shtëpiak në çerdhe, roli i edukatorit është themelor. Gjëja kryesore në këtë periudhë është krijimi besimit.

Prindërit “digjen” nga dëshira që ta dinë se çka ndodhë në çerdhe gjatë ditës. Ata dëshirojnë të dinë më shumë për ngjarjet e përditshme (ushqim, fjetje, veshje), por edhe për gjithçka tjetër (si për shembull: çka ka luajtur fëmija gjatë ditës dhe si është pajtuar me fëmijët e tjerë të grupit), por dëshirojnë të marrin edhe shënime ose, madje, edhe fotografi.

Prindërit e shohin edukatorin si burim potencial të informatave për atë se si përparon fëmija në domene të caktuara zhvillimore. Gjithnjë përgatitni shënime dhe këmbeni ato me prindërit. Kjo i jep atij siguri se ju kujdeseni për fëmijën e tij.

Gjatë largimit të prindit, tregoni qartë se e prisni fëmijën e tij edhe ditën e ardhshme.

- **Ofroju prindërve mundësi të ndryshme për inkuadrimin e tyre**

Shumica e arsimtarëve vërtet dëshirojnë të inkuadrohen në mënyrë aktive në mësimin dhe nxitjen e të arriturave zhvillimore të fëmijëve të tyre. Nëse u ofrohen opsione të ndryshme nga të cilat ata mund të bëjnë zgjedhje, prindërit i pranojnë lehtë këto iniciativa.

Jo secili prind mundet dhe ka kohë të bëjë punë vullnetare në çerdhe, por mund të punojë diçka në shtëpi (p.sh.: të riparojë ndonjë lodër të prishur, të bëjë bexha për fëmijët etj.)

Edukatorët mund t'i ftojnë prindërit në hapësirën e punës me fëmijë dhe të flasin për profesionin e tyre, të rrëfejnë ngjarje ose, madje, edhe të marrin pjesë në projekte në të cilat bëhen punime me nxënësit.

Prindërit mund të marrin pjesë në iniciativa të menduara mirë në çerdhe (p.sh.: pastrimi i oborrit, organizimi i aktiviteteve humanitare, manifestime shit-blerëse etj.)

- **Vendosni komunikim me prindërit përmes protokolleve, rregullave dhe procedurave të shkruara**

Secila organizatë që e realizon programin për kujdes dhe mësim të hershëm (ÇF/QZHVHF) patjetër duhet të ketë edhe rregulla dhe procedura të shkruara me të cilat do t'i njoftojë prindërit për mënyrë e inkuadrimit të tyre, për çmimin e programit, për polisën e sigurimit, pastaj duhet të ketë protokolle të shkruara dhe udhëzues në rast të paraqitjes së sëmundjeve të fëmija, si dhe për të gjitha politikat e tjera organizative dhe programore të ÇF/QZHVHF-ve. Këto polisa ose procedura duhet t'u jepen prindërve në formë të shkruar gjatë regjistrimit të fëmijës dhe vazhdimisht duhet të ripërtërihen nëse paraqiten ndryshime.

Informimi i qartë dhe me kohë i prindërve e zvogëlon mundësinë për keqkuptime të mëvonshme, që mund të paraqiten në komunikimin ndërmjet prindit, edukatorit ose personelit administrativ.

Ndonjëherë ÇF/QZHVHF në programet e tyre parashohin formimin e këshillave të prindërve, që kanë rol themelor në planet programore operative. Iniciativat për formimin e këshillave të këtyre të prindërve e përcjellin shumë qartë mesazhin e mëposhtëm deri te prindërit: “Ne dëshirojmë ta dëgjojmë mendimin tuaj dhe t'i kuptojmë se cilat janë qëndrimet tuaja, sepse mendojmë se ato janë shumë të rëndësishme”.

- **Orientoni prindërit si ta nxisin mësimin e hershëm të fëmijët e tyre**

Ftoni prindërit t'ju vizitojnë dhe t'u vëzhgojnë se në çfarë mënyrë e nxisni ju zhvillimin holistik të fëmijët gjatë aktiviteteve të përditshme. Lejojuni atyre ta shohin vetë se si i nxisni shkathtësitë zhvillimore të fëmijët nëpër të gjitha domenet zhvillimore.

Sugjerojuni prindërve që vetë ta nxisin zhvillimin e fëmijëve të tyre gjatë aktiviteteve të përditshme shtëpiake - biseda të përditshme me fëmijët gjatë kohës ushqimeve, leximi dhe shpjegimi i librave, vajtja në treg, përgatitja e ushqimeve, luajtja e përbashkët e ndonjë loje sportive etj.